



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER JULED A. BEQIRAJ
ADRESA NR.4, EGNATIA
TEL: 684050555

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3480

Nr. koleksioni: 2097

Durres më 07/06/2024

Juled
Beqiraj

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten :Juled
Beqiraj
Data: 2024.06.07
18:33:28+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024011520218816659



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "VINTAGE" SH.P.K)

Sot, më datë 07.06.2024, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

SHITES: Elvis Doçi, atësia Hysen, amësia Bukuriye, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Durresi Ne Shekuj 00690212; Nd. 75; H. 1; Durrës; Durrës; 2007; Durrës, lindur më 15/10/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035880869 dhe nr. personal H81015066C.

BLERES: Edmir Bakalli, atësia Ismail, amësia Sherife, shtetas Shqiptar, lindur në Sukth, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Fshati Erzen; Nd. 193; Katundi I Ri; Katund I Ri; 2017; Durrës, lindur më 04/03/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034952973 dhe nr. personal H90304168T.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Vintage" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij, Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Shitesi dhe bleresi do të referohen këtej e tutje së bashku edhe si "Palët".

KUSHTET PARAPRAKE

- Z. Elvis Doçi zotëron një kuote kapitali të barabartë me 100% (njqind përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "VINTAGE" Sh.p.k, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Durres, me NIPT nr. K71412502W (këtej e tutje referuar si "Shoqëria");
- Shitësi dëshiron ti shesi Blerësit kuoten e vet, të barabartë me 100% të pjesëve të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mbi bazën e kushteve të mëposhtme;
- Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi kapitalin e shoqërisë, ne masen 100% të pjesëve të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mbi bazën e kushteve të mëposhtme; dhe
- Asambleja e Përgjithshme me datë 03.06.2024 përpara nënshkrimit të kësaj kontrate ka miratuar transferimin e kuotës në objekt të kësaj kontrate.

**MEQË EKZISTOJNË KUSHTET PARAPRAKE,
PALËT BIEN DAKORT PËRSA MË POSHTË:**



A2024011520218816659

Neni 1 – Kushtet Paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 2 – Objekti i Kontratës

Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate:

Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen prej Shitësit një kuote të barabartë me 100% të pjesëve të kapitalit themeltar të Shoqërisë si edhe çdo të drejtë që lidhet me këto pjesë kapitali (këtej e tutje referuar si “Pjesa e Kapitalit), të lirë nga çdo barrë apo detyrim, për çmimin e parashikuar në Nenin vijues 3, të paguar sipas mënyrës së treguar në këtë nen.

Neni 3 – Çmimi dhe menyra e pageses

- 3.1 Shitësi pranon t’i shesë dhe transferojë Blerësit dhe Blerësi pranon të blejë nga Shitësi Pjesën e Kapitalit duke përfshirë të gjitha asetet që posedon shoqëria të luajtshme dhe të paluajtshme, biznesin si edhe çdo të drejtë apo, marke të mbrojtur apo cdo e drejtë tjetër, me një çmim total prej 40.000.000 leke (dyzet milion), çmim i cili Palët pranojnë se është i drejtë dhe i arsyeshëm për shitje/blerjen e Pjesës të Kapitalit të vlerësuar me vlerën nominale 100.000 (njqind mije) leke si edhe vlerën e aseteve dhe mallrave të inventarit në masën 39.900.000 (tridhjetë e nente milion e nentqind mije) leke.
- 3.2 Vlera prej 40.000.000 leke (dyzet milion), do të likuidohet me transksion bankar, brenda dates 05.06.2029, nga llogaria e Z. **Edmir Bakalli** në llogarinë bankare të **Elvis Doçi**;
- 3.3 Dorezimi i kuotes, aseteve dhe mallrave të inventarit do të bëhet menjëherë me nënshkrimin e kontrates.
- 3.4 Mandatet bankare për likuidimin total të vlerës, janë vërtetimi që plotëson rezervën e kontratës.
- 3.5 Menjëherë me nënshkrimin e kontrates, kjo kontratë do të depozitohet pranë QKB-së me qëllim kalimin e pronësise së kuotes në masën 100% në favor të pales blerese

Neni 4 – Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

- 4.1 Të dyja palët me anë të këtij akti pranojnë se transferimi i Pjesëve të Kapitalit do të ketë efekt pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj pranë QKB-se.
- 4.2 Shitësi dhe Blerësi nëpërmjet këtij akti pranojnë t’i njoftojnë dhe t’i kërkojnë Shoqërisë, në datën e likuidimit të percaktuar në pikën 3.2 të Nenit 3 të kësaj Kontrate, që ajo të ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara sipas legjislacionit shqiptar për regjistrimin e transferimit të këtyre Pjesëve të Kapitalit pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Neni 5 – Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

- 5.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, Shitësi nëpërmjet këtij akti deklaron dhe garanton se:
 - a) Shitësi është pronari i vetëm të Pjesëve të Kapitalit të cituara në Kushtet Paraprake;
 - b) Pjesët e Kapitalit janë shlyer plotësisht; dhe
 - c) Pjesët e Kapitalit janë të lira nga çdo barrë apo detyrim dhe Shitësi ka të drejta të plota për të shitur dhe transferuar Pjesët e Kapitalit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
 - d) Asetet e shoqërisë (mallrat sipas inventarit etj) janë të lira nga cdo lloj barre dhe hipoteke si edhe nuk kanë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor apo eviksioni;
- 5.2 Shitësi angazhohet, premton dhe garanton se me nënshkrimin e kësaj Kontrate:
 - a) i kalon Blerësit titullin ligjor të plotë dhe të parevokueshëm mbi Pjesën e Kapitalit;
 - b) Blerësi do të ketë të drejtën për të përfutur çdo dividend dhe të gjitha të drejtat që lidhen me to dhe se nga ky moment Shitësit nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi Pjesët e Kapitalit.



A2024011520218816659

- c) I kalon Blerësit pronësine mbi të gjitha asetet që posedon shoqëria të luajtshme dhe të paluajtshme, biznesin si edhe cdo të drejte apo, marke të mbrojtur apo cdo të drejte tjetër.

Neni 6 - Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësi nëpërmjet këtij akti deklaron dhe garanton se:

- a) Blerësi do ti paguaj Shitësit çmimin total të parashikuar në Nenin e mësipërm 3.1; dhe
- b) Blerësi ka kryer due diligence-n e tij ligjore, fiskale dhe kontabël lidhur me biznesin dhe veprimtarinë e Shoqërisë dhe se ai nuk është bazuar apo nuk bazohet në ndonjë deklaram apo garanci të Shitësit, përveç atyre të parashikuara në këtë Kontratë.

Neni 7 – Trashëgimtarët apo përfituesit nga ndonjë kalim apo cedim

Kjo Kontratë do të jetë detyruese apo në përfitim të Palëve dhe trashëgimtarëve apo përfituesve të tyre për shkak të ndonjë kalimi apo cedimi.

Neni 8 – Shpenzimet dhe Taksat

Të gjitha shpenzimet ligjore, të noterisë apo shpenzimet e tjera lidhur me këtë Kontratë do të përballohen nga pala blerese.

Neni 9 - Njoftimet

Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera të kërkuara ose që duhet të jepen sipas kësaj Kontrate do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë nëse i dorëzohen Palëve personalisht apo postohen me postë rekomande (me kthim përgjigje) në adresat e paleve.

Neni 10 – Legjislacioni i zbatueshëm

Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e Palëve do të rregullohen dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 11 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, përfundimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, Palët do të takohen dhe përpiqen në mirëbesim të zgjidhin sa më shpejt që të jetë e mundur mosmarrëveshjen në fjalë. Nëse kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve ndërmjet Palëve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga kërkesa e parë për takim, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Neni 12 - Forca Madhore

Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se përmbushja e çfarëdolloj dispozite në këtë Kontratë do të vonohet ose ndalohet për shkak të forcave madhore dhe në mënyrë të veçantë për shkaqet e mëposhtme: revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftëra, greva, zjarre, vërshime, fenomene të natyrës, shpronësime, ose akte qeveritare që kufizojnë lirinë personale apo atë të sipërmarrjes të çdonjërit nga Palët.

Neni 13 – Të ndryshme

- 13.1 Kjo Kontratë e shkruar përbën të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme verbale apo me shkrim dhe çdo komunikim tjetër të mëparshëm ndërmjet Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.
- 13.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, çdo ndryshim i kësaj Kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim, nënshkruar nga të dyja Palët.
- 13.3 Palët pranojnë se kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund t'i bëhen të ditura palëve të treta, përveç rasteve kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
- 13.4 Kjo Kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në shqip.



A20240115202168 0019

Për sa më sipër, Palët deklarojnë, se kjo Kontratë është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruajnë atë në praninë time, Noterit, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Shitësi

Elvis Doçi

Blerësi

Edmir Bakalli

NOTER

JULED A.BEQIRAJ



REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20240607154042403
Data e Rezultatit të Kerkimit:	07.06.2024
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	15:40:42
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Juridik
Numri i Dokumentit:	D-400-634-6297

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

VINTAGE SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi
JULED ADIL BEQIRAJ P.F.

Ada Qoqja

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri
ADA QOQJA

